



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 16

Prishtinë, më 22.7.2011, ora 10,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Liburn Aliu, Afërdita Berisha-Shaqiri, Nijazi Idrizi, Etem Arifi, Salih Morina, Daut Haradinaj dhe Sevdije Lama.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtarë, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës ,**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 13.7.2011,**
3. **Shqyrtimi i projektligjit për Kadastër për leximin e dytë,**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.7.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 13.7.2011.

3. Shqyrtimi i projektligjit për Kadastrin për leximin e dytë

Kryetari Nait Hasani fillimisht falënderoi anëtarët e komisionit për mirëkuptim rreth takimit të sotëm i cili është rezultat i procedurave urgjente për të hyrë në leximin e dytë projektligji për Kadastrin, në fakt ky projektligj ka kaluar procedurën e duhur pranë komisioneve të përhershme ku nuk ka pasur vërejtje nga asnjëra, ndaj komisioni sot duhet të konfirmojë atë për leximin e dytë. Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

Projektligji për Kadastrin përcjellët për mbledhjen plenare në leximin e dytë me amendamentet e propozuara nga ky komision funksional.

Të ndryshme

Kryetari konstatoi se projektligji për verëra me amendamentet e propozuara nga ky komision, ende është në procedurën e miratimit nga komisionet e përhershme, ndaj nëse do të ketë mundësi për procedim në leximin e dytë do të veprohet shpejt nga ky komision, nëse jo, mbetet për shtatorë.

Vizita në Komunën e Prizrenit (Rahovec) dhe Pejës (Klinë) do të realizohet të hënën dhe të martën më 25 dhe 26 korrik 2011.

Mbledhja përfundoi në orën 10,20.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani